



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.05/ 32 prot.

Datë 12.03.2025

V E N D I M
Nr.355/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.03.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.316/2025, datë 03.03.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-30351-11-20-2024, me objekt: “Rikonstrukcion i shkollës së mesme profesionale " Hasan Gina" Lushnjë” me fond limit 143,156,814.44 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara
- Ankimues:** BOE “MF INVEST GROUP” SHPK, “C.E.C GROUP” SHPK, dhe “Mane/S” SHPK me NIPT L71830010R, L11807013M, J64103865K dhe adresë: Autostrada Tirane -Durres, km 9 zona kadastrale 2005 nr pasurie 1/94 (prane OST -se)
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve te Perqendruara me adresë: Rruga: “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 03.03.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 316/2025, ku vendosi:

- 1. Të mos lejohet autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-30351-11-20-2024, me objekt: “Rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale “ Hasan Gina” Lushnjë” me fond limit 143,156,814.44 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.*
- 2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit në përputhje me konstatimet e KPP të shprehura në vendimin nr 249/2025 datë 18.02.2025.*
- 3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

I.2. Me shkresën nr.2232/12 prot., datë 06.03.2025, protokolluar me tonën nr. 05/27 prot., datë 10.09.2025, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 319/2025 datë 03.03.2025 duke i bashkëngjitur shkresës edhe procesverbalin e datës 06.03.2025 për rivlerësimin e procedurës.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr.2232/12 prot., datë 06.03.2025, protokolluar me tonën nr. 05/27 prot., datë 10.09.2025, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 319/2025 datë 03.03.2025 duke i bashkëngjitur shkresës edhe procesverbalin e datës 06.03.2025 për rivlerësimin e procedurës.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, si dhe dokumentacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka rishikuar arsyet e skualifikimit për BOE ankimes “MF Invest Group” SHPK dhe “ C.E.C Group” SHPK dhe “Mane/S” SHPK e cila është në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.249/2025 datë 18.02.2025.

II.3. Së më lart, referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ dhe raportit të auditit në SPE rezulton se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin e KPP Nr. 319/2025 datë 03.03.2025

për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-30351-11-20-2024, me objekt: “Rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale " Hasan Gina" Lushnjë” me fond limit 143,156,814.44 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-30351-11-20-2024, me objekt: “Rikonstruksion i shkollës së mesme profesionale " Hasan Gina" Lushnjë” me fond limit 143,156,814.44 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

